

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9780, DATË 16.7.2007, “PËR
INSPEKTIMIN DHE MBROJTJEN E TERRITORIT NGA NDËRTIMET E
KUNDËRLIGJSHME” TË NDRYSHUAR””

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” të ndryshuar””*

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- efektet e mundshme në zbatimin praktik nga institucionet përkatëse;
- çdo aspekt që mund të ndihmojë në rritjen e efektivitetit dhe zbatueshmërisë së projektaktit në praktikë.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektvendimit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë pune, nga data 18 dhjetor 2025 deri më 15 janar 2026.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>;
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Ky projektligj është hartuar nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Projektligji i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Mjedisit, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Departamentit të Administratës Publike, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

Sfondi i propozimit legjislativ:

Qëllimi i projektligjit lidhet me përfundimin e reformës së nisur në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, si dhe me forcimin e mekanizmave të kontrollit, disiplinimit të punimeve të ndërtimit dhe inspektimit të mbrojtjes së territorit nga ndërtime të kundërligjshme. Në këtë kuadër, projektligji synon të garantojë ushtrimin e veprimtarive ndërtimore dhe të aktiviteteve të tjera territoriale në përputhje me lejet e miratuara dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Objektivi kryesor është krijimi i një strukture të vetme kontrolli dhe inspektimi, në nivel qendror dhe me degë rajonale, e cila të ushtrojë funksionet e kontrollit dhe inspektimit të territorit.

Projektligji synon ngritjen e një sistemi modern, efikas dhe të integruar inspektimi, i cili përfshin jo vetëm aspektet e kontrollit të zhvillimit të territorit, por edhe ato që lidhen me mjedisin dhe administrimin e fondit pyjor. Ky harmonizim lidhet ngushtësisht me kërkesat e Ligjit nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, duke siguruar përputhshmëri të plotë ndërmjet dispozitave sektoriale dhe kuadrit të përgjithshëm inspektues.

Propozimet:

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara synohet arritja e disa objektivave kryesore:

Riorganizimi i strukturave vendore të mbikëqyrjes së territorit dhe krijimi i një strukture të vetme për inspektimin, me qëllim rritjen e koherencës institucionale dhe shmangien e fragmentimit të kompetencave;

Rritja e efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së proceseve inspektuese, në funksion të forcimit të shtetit ligjor dhe mbrojtjes së interesit publik;

Harmonizimi i kuadrit ligjor me legjislacionin në fuqi për inspektimin dhe me praktikën bashkëkohore të administrimit publik;

Garantimi i vazhdimësisë operationale, nëpërmjet përcaktimit të mekanizmave të qartë organizativë, funksionalë dhe proceduralë.

Këto objektiva, të ndërlidhura ndërmjet tyre, përbëjnë bazën për një sistem inspektimi të integruar, të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm, i cili rrit kapacitetet shtetërore për mbrojtjen e territorit, siguron respektimin e ligjit dhe shërben si instrument thelbësor për zhvillim të rregullt dhe të kontrolluar.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Si mendoni se mund të ndikojë ky projektligj në:

a. forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe inspektimit të territorit, në shmangien e fragmentimit të kompetencave dhe në rritjen e koherencës institucionale ndërmjet nivelit qendror dhe atij rajonal?

b. rritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies së proceseve inspektuese, si dhe në garantimin e një zhvillimi të rregullt, të qëndrueshëm dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e territorit dhe mjedisit?